

20081352660

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

Në përputhje me nenin 14 paragrafi 12 të ligjit “Për armët” (“Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 7/05, 47/06, 42/07 dhe 86/08), Ministri i Punëve të Brendshme miratoi

RREGULLOREN PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES PËR PROGRAMIN E AFTËSIMIT PËR PËRDORIMIN E DUHUR, RUAJTJEN DHE MIRËMBAJTJEN E ARMËS, MËNYRËN E REALIZIMIT TË AFTËSIMIT PRAKTIK PËR PËRDORIMIN E ARMËVE, SI DHE MËNYRËN E REALIZIMIT TË PROVIMIT PROFESIONAL PËR KONTROLLIN E NJOHURIVE TEKNIKE PËR PËRDORIMIN E DUHUR TË ARMËS DHE NJOHURIVE TË RREGULLOREVE PËR ARMËT

Neni 1

Në Rregulloren që ndryshon Rregulloren për programin e aftësimit për përdorimin e duhur, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e armës, mënyrën e realizimit të aftësimit praktik për përdorimin e armëve, si dhe mënyrën e realizimit të provimit profesional për kontrollin e njohurive teknike të përdorimit të duhur të armës dhe njohurive të rregulloreve për armët (“Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 83/05), neni 7 fshihet.

Neni 2

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën pas botimit në “Fletoren Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.

Numër 13.1-74363/1
21 tetor 2008
Shkup

Ministre
e Punëve të Brendshme,
MA Gordana Jankuloska, nënshkrimi